



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË



Universitatea
Transilvania
din Braşov

Thirrje për mobilitet stafi për mësimdhënie në kuadër të Programit Erasmus+ për komponentin KA1 në Universitetin e Transilvanisë të Brasov në Rumani

Universiteti i Vlorës "Ismael Qemali", në bashkëpunim me Universitetin e Transilvanisë të Brasov në Rumani (Transilvania University of Brasov) në kuadër të Programit Erasmus+ për komponentin KA1, fton stafin akademik të punësuar me kontratë me afatë të pacaktuar në UV, të aplikojnë për të përfituar një bursë për mësimdhënie për një periudhë prej **6+2** ditësh në Universitetin e Transilvanisë të Brasov në Rumani.

Mobiliteti në këtë institucionin pritet të përmbushet brenda **semestrit të dytë** të vitit akademik **2018-2019**.

Shpenzimet do të mbulohen nga skema Erasmus +, komponenti KA1 për mobilitet stafi. Ato parashikojnë shumën prej **275 Euro** për udhëtimin vajtje-ardhje si dhe dietën ditore prej **140 Euro/ditë**.

Numri i bursave për mësimdhënie: 1 (një)

Kriteret për aplikantët:

- të jetë staf efektiv i Departamentit të Gjuhëve të huaja;
- të ketë përvojë akademike dhe shkencore në fushat e sipërpërmendura;
- të argumentojë qartazi qëllimin e vizitës në institucionin pritës.

Kriteret e përzgjedhjes: (në varësi të universitetit pritës)

- Titulli/ grada shkencore
- Prioritet i jepet stafit që nuk ka patur më parë eksperiencë mobilitetit.
- Njohja e gjuhës së huaj sipas nivelit të përcaktuar në marrëveshjen ndër-institucionale.
- Kriteret e tjera shtesë mund të përfshijnë:
 - Motivimi
 - Vjetërsia në punë
 - Barazia gjinore (aty ku është e mundur të përzgjidhen kandidatë të barabartë në numër për nga gjinia).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formular aplikimi
- Kopje të pasaportës
- Vërtetim punësimi
- CV
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohjen e gjuhës angleze
- Letër argumentuese (rreth 300 fjalë) në gjuhën angleze lidhur me qëllimin dhe përfitimin institucional të mobilitetit, bazuar në prioritetet e nënvizuara sipas udhëzimeve të Komisionit Evropian për këtë skemë.
(<https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/organisations#tab-1-1>).

Dokumentet e aplikimit duhet të dorëzohen pranë Sektorit të Projekteve dhe Marëdhënieve me Jashtë brenda datës **16/11/2018** ora **16:00**.

Kandidatët fitues do të njoftohen prej Sektorit të Projekteve dhe Marëdhënieve me Jashtë brenda datës **23/11/2018** ora **16:00** në adresën e tyre të e-mailit.

Për përzgjedhjen e stafit akademik ngrihet një komision, i cili vlerëson stafin.

Procesi i brendshëm i përzgjedhjes nuk garanton që mobiliteti do të kryhet. Përzgjedhja duhet të konfirmohet nga institucioni pritës përmes një letre pranimi/ftese.

Për të dhëna të mëtejshme rreth skemës së mobilitetit dhe mënyrës së aplikimit mund të kontaktoni me Prof. As. Bledar Toska: bledar.toska@univlora.edu.al për Marrëveshjen ose me Sektorin e Projekteve dhe Marëdhënieve me Jashtë, pranë Rektoratit, Kati i I.

SUKSESE!